

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHETËTËRORE 2010

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Njohuri për shoqërinë

Varianti A

30 qershor 2010

• *Pyetjet me zgjedhje dhe zhvillim*

Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.

- | | |
|---|--------|
| 1. C – patriarkale | 1 pikë |
| 2. B - simbol kulturor | 1 pikë |
| 3. A - shok kulturor | 1 pikë |
| 4. | 3 pikë |
| a) përhapja e elementëve të një kulture nga njëri sistem kulturor te tjetri | 1 pikë |
| b) marrja nga një kulturë te një tjetër e elementëve kulturorë që i përshtaten asaj
ose
marrja e elementëve që ndryshojnë në përshtatje me kulturën ku depërtojnë | 1 pikë |
| c) transmetimi i kulturës
ose
funksionimi i institucioneve | 1 pikë |
| 5. | 3 pikë |
| a) grupe që kanë të përbashkëta elementët kryesorë me kulturën sunduese,
por ndryshojnë në aspekte të veçanta | 1 pikë |
| b) kultura e një grupimi që i përmbahet një ose disa vlerave kulturore dhe i kundërvihen atyre sunduese | 1 pikë |
| c) norma kulturore të rëndësishme | 1 pikë |
| 6. | 3 pikë |
| a) organizatë fetare zyrtare që nuk lidhet zyrtarisht me shtetin | 1 pikë |
| b) organizatë fetare jozyrtare, që nuk janë të mirëintegruara brenda shoqërisë
Nxënësi vlerësohet me 1 pikë edhe nëse jepen veçoritë e sektit. | 1 pikë |
| c) kult | 1 pikë |

- 7.** **4 pikë**
a) emocional-ftohje marrëdhëniesh-mosmarrëveshje, kontradikta (mjafton njëra) *1 pikë*
b) detyrime dhe të drejtat ndaj fëmijëve *1 pikë*
c) rregullimi i marrëdhënieve të ish-bashkëshortëve me të afërmit *1 pikë*
d) shkëputja (ndarja) përfundimtare *1 pikë*
- 8. A** - *jo vetëm në kohë dhe hapësirë, por edhe emocionalisht dhe psikologjikisht* **1 pikë**
- 9. C** - *shkolla* **1 pikë**
- 10. C** - *ajo nuk është e vlefshme për disa grupe të veçanta* **1 pikë**
- 11. D** - *të gjitha alternativat e mësipërme* **1 pikë**
- 12.** **4 pikë**
a) - disa sjellje deviante janë të nevojshme *1 pikë*
 - *luajnë rol për shoqërizimin*
 - *devijime të vogla nxisin forcimin e besimit*
b) - kundërshtimi i përbashkët për një sjellje deviante *1 pikë*
 - *në shoqëri të përziara (apo mes emigrantëve)disa sjellje deviante forcojnë solidaritetin*
c) - përcaktimi devijant ose jo është relativ *1 pikë*
 - *disa sjellje deviante janë të padukshme. Të tjera janë të dukshme dhe bëhen si kufij moralë*
d) - thyerjet e disa lloj rregullash përkrahen më pas nga të gjithë *1 pikë*
 Nxënësi merr pikë edhe kur ndonjë funksion e trajton me shembull
- 13.** **2 pikë**
 - *rritja e popullsisë më shpejt se rritja e të mirave materiale* *2 pikë*
 ose
 - *rritja e popullsisë në progresion gjeometrik* *1 pikë*
 - *rritja e të mirave materiale në progresion aritmetik* *1 pikë*
- 14. D** - *motivohen më shumë nga interesa vetjake se sa nga dëshira për mbarëvajtjen e anëtarëve të tjerë* **1 pikë**
- 15.** **3 pikë**
 a) fanatik veprues *1 pikë*
 b) fanatik i ndrojtur *1 pikë*
 c) liberal *1 pikë*

- 16. B - asimilimi** **1 pikë**
- 17. A - debat publik** **1 pikë**
- 18.** **2 pikë**
- a) vullneti i popullit në veprim *1 pikë*
- b) pushtetin e popullit për të thënë fjalën e tij për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjeve
- ose**
- të politikave të zbatuara në emër të ligjit *1 pikë*
- 19.** **3 pikë**
- a) politika dhe vlera shoqërore që nxisin garën paqësore të ideve dhe programeve politike brenda kufijve moralë e institucionalë: *1 pikë*
- parime të përbashkëta kushtetuese
 - angazhim i gjerë në përdorimin e mjeteve institucionale për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve
 - pluralizëm politik
 - barazi e qytetarëve në statusin e tyre politik
- b) struktura shoqërore që edukojnë shprehi qytetare demokratike dhe lëvizshmëri shoqërore *1 pikë*
- ekzistenca e një klase të mesme të zhvilluar
 - mungesa e hendeqeve të skajshme të pasurisë dhe varfërisë
 - mungesa e strukturave klasore të ngurta
 - mundësia e shfrytëzimit të njohurive dhe të burimeve teknologjike
 - ekzistenca e një shoqërie civile të zhvilluar dhe aktive
 - diversiteti dhe pluralizmi shoqëror
- c) qëndrime shoqërore, që mbështesin formimin e kapitalit shoqëror, që lejon funksionimin e proceseve demokratike: *1 pikë*
- besimi i gjerë shoqëror
 - mungesa e armiqësisë së ndërsjellë ndërmjet grupeve shoqërore
 - barazia shoqërore
- Nxënësi merr pikën përkatëse të çdo kërkesë nëse ai përmend të paktën një nga përgjigjet e listuara në secilën kërkesë.
- 20.** **3 pikë**
- e drejta dhe mundësia për t'u informuar *1 pikë*
 - përgjegjësi të përcaktuara *1 pikë*
 - ndarja e funksioneve *1 pikë*